

PROCESVERBAL
nga seanca e 22-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 18.12. 2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Petar Xhurovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Viktor Pavlovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga Shërbimit Profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: dr. Ivana Stojanovska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 22-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim- procesverbalit të seancës 21. të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtura më 12.12.2025.
2. Propozim-rregullore për plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
3. Të ndryshme .

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 12.12.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski shpjegoi se plotësimi i propozuar i Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, paraqet harmonizim ligjor të Rregullores.

Këshilltarja Gordana Majnova deklaroi se në lidhje me këtë pikë, pret që gjatë vitit të ardhshëm përsëri të hapet Rregullorja për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me propozime për ndryshime dhe plotësime të caktuara.

Kryetari Sasho Stefanovski sqaroi se statuti i punës së Agjencisë mundëson që secili akt nënligjor, në çdo kohë, sërish të rishikohet dhe sipas nevojës të propozohen ndryshime ose plotësime.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuar.

Plotësimi i Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele buron nga dispozita e përfshirë në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sipas të cilit anëtarët e Këshillit të Agjencisë janë të angazhuar profesionalisht në Agjenci, me orar të plotë.

Rregullorja për plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të publikohet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike është i detyruar të përgtisë tekst të pastruar të Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pika 3

Të ndryshme

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendim për pagesë të regresit për pushim vjetor për vitin 2025 për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Për pagesën e kompensimit, mjetet janë siguruar nga Plan i Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025.

Vendimi për pagesë të regresit për pushim vjetor për vitin 2025 hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të realizohet pas përmbushjes së kushtit për pagesë, duke filluar nga data 25.12.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**